



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI**

Nr. 3767 Prot

Gramsh më 01/08.2025

THIRRJE PUBLIKE PËR KËSHILLIN VENDOR TË RINISË

Bashkia Gramsh shpall thirrjen publike për anëtarësimin në Këshillin Vendor të Rinisë Gramsh. Thirrja është e hapur për të gjithë të interesuarit që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të jenë banorë të bashkisë Gramsh
- b) të jenë 15 deri 29 vjeç;
- c) të jenë përfaqësues të një organizate rinore ose për të rinjtë;
- d) të mos jetë i dënuar;
- e) të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rinore për të rinjtë;
- f) të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit të Këshillit Vendor Rinor.

Kandidatët për Këshillin Vendor Rinor, përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë duhet të paraqesin interesin e tyre brenda afatit të përcaktuar, në adresën: pranë Bashkisë Gramsh, Sheshi "Kamber Dërmyshi" Bulevardi "10 Korriku", duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesë me shkrim ku të shprehë interesin dhe motivimin për aplikim;
- b) jetëshkrim;
- c) fotokopje të dokumentave që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
- d) vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;
- e) referenca nga të paktën 2 bashkëpuntorë të mëparshëm;

Thirrja për kandidatët e Këshillit Vendor Rinor publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes bëhet nga grupi i punës, i ngritur pranë Bashkisë Gramsh, duke u bazuar në kriteret dhe procedurat që parashikon ligji. Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e tyre bëhet brenda 10(dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve.

Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.

Të përzgjedhurit njoftohen dhe bëhet prezantimi me Këshillin Vendor Rinor Gramsh.

